

MARRËVESHJE

PËR PAGESËN E TARIFAVE MUJORE PËR SHFRYTËZIMIN E LËNDËS SË MBROJTUR ME RASTIN E RITRANSMETIMIT

Duke u mbështetur në nenin 102 dhe 103 LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA, duke marr për bazë tarifat e përcaktuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 12/36 të datës 19.10.2020 i ndryshuar me vendimin nr. 13/38 të datës 30.10.2020, si dhe marr parasysh shqetësimin e operatorëve kabllor në lidhje me vështirësitë që kanë për të paguar vlerën e akumuluar, përfaqësuesit e Shoqatës për Menaxhim Kolektiv të të Drejtave të Autorit VAPIK dhe operatorët në vijim:

ARTMOTION SH.P.K. me seli në Prishtinë, me adresë në Zonën Industriale, Rr. "Lidhja e Pejës", me numër Unik Identifikues; 810200866, të cilën e përfaqëson Kushtrim Gojani;

IPKO Telecommunications L.L.C., me seli në Rr. Zija Shemsiu, nr. 34, Prishtinë, Kosovë, me numër unik identifikues 810485301, përfaqësuar nga Drejtor Menaxhues, András Páli;

KUJTESA NET SH.P.K shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës me numër unik identifikues 810547862, me seli në adresën Km. 7 Magjistranja, Prishtinë Ferizaj 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës dhe e përfaqësuar nga Fatmir Sefa;

Telkos, me seli në Rr. Elez Berisha, nr. 30, Prishtinë, Kosovë, me numër unik identifikues 810868995, përfaqësuar nga Drejtori i Telkos, Enver Berisha.

Në prezencë të përfaqësuesve të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, pajtohen për kushtet si vijon:

1. Palët pajtohen për zbatimin e tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e lëndës së mbrojtur me rastin e ritransmetimit, sic përcakton Vendimi, nr. 12/36, i datës 19.10.2020, me efektivitet nga data 1 prill 2021 e deri më 31.12.2024. Si rrjedhojë, VAPIK dhe operatorët do të lidhin marrëveshje veç e veç për përcaktimin e mënyrës së pagesës së vlerës së akumuluar deri në ditën e fundit të muajit të nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, jo më larg se deri më 31 korrik. Periudha brenda të cilës vlera e akumuluar duhet paguar, nuk do të jetë më e gjatë se 4 vite nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes, me përjashtim të operatorëve të cilët pajisen më pëlqim nga ana e VAPIK, për zgjatje të afatit, i cili nuk mund të kaloj periudhën prej 5 vitesh. Në secilin rast, marrëveshjet sa i përket borxhit të akumuluar, për çështjen e ofrimit të transparencës së duhur, do të publikohen nga ana e VAPIK. VAPIK, garanton se, përveç publikimit të marrëveshjeve, të gjitha informacionet lidhur me pagesat e ekzekutuara, borxhet e akumuluar eventuale nga ana e operatorëve, do të raportohen pranë Ministrisë.

- ii. VAPIK do të lëshoj një faturë për totalin e detyrimeve të grumbulluara për secilin operatorë veç e veç. Operatorët kabllor obligohen që, jo më gjatë se në 3 këste mujore fillestare, të bëjnë pagesën e TVSH-së së faturës totale për detyrimet e akumuluar, siç do të përcaktohet e detajuar në marrëveshjen për përcaktimin e mënyrës së pagesës. Pjesën e mbetur, operatorët do të pajtohen për pagesë në marrëveshjen përkatëse, sipas kësteve, të cilat duhet filluar së paguari 3 muaj pas pagesës së TVSH-së, nga operatorët. Në rast se, ndonjë nga operatorët, nuk arrinë përmbushjen e detyrimeve sipas afateve të përcaktuara, operatori që realizon vonesën, detyrohet që, ndaj VAPIK, përveç kamatëvonesës, të paguaj çfarëdo ngarkese financiare që kjo e fundit, i nënshtrohet nga Administrata Tatimore e Kosovës.
- iii. Me qëllim të zbatimit të pajtueshmërisë nga paragrafi paraprak, në muajin vijues të nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, operatorët do të vijojnë më pagesën e tarifës së përgjithshme për shfrytëzimin e lëndës së mbrojtur siç përcakton Vendimi i Qeverisë, i aplikueshëm deri më datë 31 dhjetor 2024.
- iv. Palët pajtohen që tarifat për vitet 2025, 2026, 2027 dhe 2028 të zbatohen me zbritje si në këtë tabelë:

Shkallëzimi i pakove bazuar ne numrin e Kanale	Tarifa per vitin 2025	Tarifa per vitin 2026	Tarifa per vitin 2027	Tarifa per vitin 2028
0-100 Kanale	0.1875 €	0.1875 €	0.1875 €	0.1875 €
101-150 Kanale	0.2000 €	0.2000 €	0.2000 €	0.2000 €
Mbi 150 Kanale	0.2375 €	0.2375 €	0.2375 €	0.2375 €

- v. Tarifave ju shtohet tvsh e aplikueshme.
- vi. Palët pajtohen që të shkëmbejnë informata mes tyre sipas kërkesave reciproke me qëllim të implementimit të kësaj Marrëveshje. Operatorët kabllor në mënyrë specifike marrin përsipër që në baza mujore, jo më larg se data 10 e muajit vijues, të raportojnë të dhëna të sakta rreth numrit të abonuesve dhe kanaleve në përmbajtjen e tyre programore, sipas pakove specifike, sic kërkohet së plotësuari në formularin e VAPIK, bashkangjitur si shtojcë 1. Për nevojat e kësaj Marrëveshje, raportimi mujor do të bëhet duke paraqitur pasqyrën (snapshot) e ditës së fundit

të muajit përkatës të abonuesve aktiv në shërbimet e televizionit digjital, ashtu siç bëhet edhe raportimi i numrave në raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media.

- VII. Pas pranimit të formularit të plotësuar dhe shqyrtimeve adekuate, VAPIK, do të lëshoj faturën sa i përket obligimeve mujore të operatorëve kabllor individualisht. Pagesa e faturës duhet realizuar brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e lëshimit të faturës. Në rast vonese, aplikohet kamata ligjore siç e përcakton Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në fuqi.
- VIII. Palët pajtohen që, të njëjtit nuk do të kërkojnë ndryshimin e tarifave për komplet periudhën e dakorduar.
- IX. Palët pajtohen të negociojnë për tarifën që do të aplikohen nga viti 2029, siç përcakton Ligji. Në rast të mosarritjes së marrëveshjes për përcaktimin e tarifave, do të procedohet sipas përcaktimit të ligjit. Me qëllim implementimin e kësaj marrëveshje, Shoqata për Menaxhim Kolektiv të të Drejtave të Autorit ndërmerr si vijon:
- i. të shpërndaj tek bartësit e të drejtave kompensimet e mbledhura në mënyrë proporcionale, siç përcakton Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
 - ii. në kuadër të veprimtarisë dhe autorizimeve, të kujdeset për administrimin e të drejtave për bartësit vendorë dhe të huaj, pavarësisht vendndodhjes së tyre.
 - iii. Të ndërmarr në bashkëpunim me operatorët kabllor dhe organet e rendit aktivitetet për luftimin e transmetimeve ilegale të përmbajtjes televizive.
- X. Mbulimi i të drejtave nga ana e Shoqatës, bëhet në sistemin ONE STOP SHOP, sa u përket shërbimeve audiovizuale.
- XI. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, palët heqin dorë nga çfarëdo pretendimi tjetër lidhur me objektin e kësaj Marrëveshje, përveç siç parashikohet këtu.
- XII. Operatorët kabllor do të bëjnë tërheqjen e padisë lidhur me objektin e kësaj Marrëveshjes, në afat prej 15 ditësh nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshje. E njëjta, do të evidentohet nga ana e operatorëve kabllor me dorëzimin e kopjes së parashtrësës pranë VAPIK dhe MKRS, Zyra për të Drejtat e Autorit.
- XIII. VAPIK do të bëjë tërheqjen padisë ndaj operatorëve të cilët e nënshkruajnë marrëveshjen, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të pagesës së kësaj të parë të borxhit të akumuluar. E njëjta, do të evidentohet nga ana VAPIK, me dorëzimin e kopjes së parashtrësës pranë operatorit kabllor përkatës.

XIV. Klauzola Kundër Korrupsionit:

Palët deklarojnë se, ata nuk kanë bërë dhe nuk do të bëjnë, në asnjë fazë të ekzekutimit të kësaj Marrëveshje, asnjë lloj premtimi, apo lloj tjetër përfitimi të paligjshëm për nevoja personale apo të palëve të treta, lidhur me konkludimin e këtij transaksioni; hyrjen në këtë transaksion; lëshimin e ndonjë kontrolli të duhur mbi ekzekutueshmërinë e kësaj Marrëveshje; ose, çfarëdo veprimi tjetër që shkakton dëm ndaj njërës palë, apo që mundëson përvetësimin e fitimit në mënyrë të paligjshme për vete, punonjës, anëtar bordi, mbikëqyrës ose përfaqësues të ndonjëres palë.

Në rast të shkeljes apo tendencës për shkelje të kësaj klauzole, kjo Marrëveshje do të bëhet e pavlefshme.

XV. Konfidencialiteti:

Të gjitha dokumentet lidhur me këtë Marrëveshje, që përbëjnë sekret tregtar, konsiderohen konfidenciale. Çdo person, punonjës apo tjetër, që realizojnë qasje në sekretin tregtar detyrohen të mos zbulojnë të njëjtat tek ndonjë palë e tretë, pa pëlqimin adekuat me shkrim të personit të autorizuar nga pala që kërkohen të zbulohen informatat. Përrjashtime në këtë aspekt, mund të aplikohen vetëm nëse si të tilla, kërkohen sipas legjislacionit të zbatueshëm.

Nga personat që realizojnë qasje në informata konfidenciale, duhet kërkuar të mbahen konfidencialiteti gjatë gjithë vlefshmërisë së kësaj Marrëveshje, si dhe pas ndërprerjes së kësaj Marrëveshje, nëse e aplikueshme, deri në momentin kur këto informata, të mos konsiderohen konfidenciale nga pala që korrespondon informacioni apo deri në momentin që këto informata bëhen të disponueshme publikisht.

XVI. Mbrojtja e të dhënave personale:

Operatorët kabllor si dhe VAPIK, pajtohen për të trajtuar të gjitha të dhënat personale të cilat i janë shpalosur në vijim të zbatimit të kësaj Marrëveshje, në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të përdorën si të tilla vetëm për qëllime të implementimit të kësaj Marrëveshje.

VAPIK në këtë drejtim, si disponues i informatave konfidenciale të operatorëve kabllor, ndërmerr të sigurojë të gjitha procedurat dhe masat e nevojshme organizative, teknike dhe logjike, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi, për të mbrojtur të dhënat e tyre personale, të parandalojë çdo shkatërrimin aksidental apo të qëllimshëm të paautorizuar të dhënave, ndryshimin e tyre dhe përpunimin e paautorizuar të dhënave të tilla.

XVII. Njoftimet dhe Kontaktet

Të gjitha njoftimet, kërkesat e shkëmbyera për ekzekutimin e kësaj Marrëveshje, do të bëhen në formë të shkruar dhe do të dërgohen përmes postës elektronike

apo të regjistruar, siç përcaktohet më poshtë. Të njëjtat, do të kenë efekt në momentin e pranimit nga pala marrëse. Nëse e nevojshme, nga pala dërguese mund të kërkohet pranimi nga pala marrëse.

Të gjitha komunikimet mund të adresohen tek personat kontaktues, si vijon:

ARTMOTION

Emri, Mbiemri: Sotir Sokoli

Adresa: Rr. "Lidhja e Pejës" 10000, Prishtine.

E-mail: sotir.sokoli@artmotion.net

Tel: +383 44 356 685

IPKO TELECOMMUNICATIONS LLC

Arboneta Thaci

Adresa: IPKO Telecommunications, Zona Industriale, Prishtine

E-mail: arboneta.thaci@ipko.com

Tel: 038/049 700 016

KUJTESA

Emri, Mbiemri: Fatmir Sefa

Adresa: Km. 7 Magjistranja, Prishtinë Ferizaj

E-mail: fatmir.sefa@kujtesa.net

Tel: +383 48 277 772

TELKOS

Emri, Mbiemri: Enver Berisha

Adresa: Rr. Elez Berisha, nr. 30

E-mail: enver.berisha@telkos.net

Tel: +383 44 990 049

VAPIK

Emri, Mbiemri: Lirak Çelaj

Adresa: Rr. Luan Haradinaj 11/1, kati/floor IV, 10000 Prishtinë, Kosovë

E-mail: lirakcelaj@vapik-ks.org

Tel: +383 44 500 514

XVIII. Palët do të informojnë njëra-tjetrën për çdo zëvendësim të përfaqësuesve, me shkrim, brenda tre (3) ditëve nga zëvendësimi. Në rast se, Shoqatës u nënshtrohet procedurave të revokimit të licencës, apo, nëse operatori kabllor i nënshtrohet falimentimit apo ndonjë procedure tjetër të likuidimit, palët do të lirohen nga obligimi i përmbushjes së obligimeve sipas kësaj Marrëveshje.

XIX. **Ligji Qeverisës dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Kjo marrëveshje, i nënshtrohet dhe interpretohet në pajtueshmëri me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

Palët ndërmarrin që, në rast të mosmarrëveshjeve, të arrijnë zgjidhjen në mënyrë miqësore. Në të kundërtën, çdo mosmarrëveshje do të jetë objekt shqyrtimi nga Gjykata kompetente në Prishtinë.

- XX. Për periudhën 01.04.2021 e deri më 31.07.2024, operatorët do të raportojnë për secilin muaj veç e veç deri më datë 10.08.2024, pastaj VAPIK do të lëshon një faturë për pagesën e tarifave për këtë periudhë, ndërsa për pjesën tjetër do të faturohet në baza mujore.
- XXI. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet nga VAPIK, dhe Ministria e Kulturës në ueb faqet e tyre.

Kjo marrëveshje u ndërmjetësua nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës si dhe Komisioni i Pavarur për Media.

PALET NËNSHKRUESE

- VAPIK
Lirak Çelaj

Operatorët kabllor :

1. Artmotion
Kushtrim Gojani
2. IPKO Telecommunications L.L.C.
András Páli
3. Kujtesa
Fatmir Sefa
4. Telkos
Enver Berisha

